



TWIST

DREJT NJË MODELI TË RI TË SIPËRMARRJES SOCIALE NË ASETET E KONFISKUARA NË SHQIPËRI



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian në kuadër të projektit "TWIST - Drejt një modeli të ri të sipërmarrjes sociale në asetet e konfiskuara në Shqipëri", zbatuar nga LIBERA-shoqata, emra dhe numra kundër mafias, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Bashkia Tiranë, në bashkëpunim me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



© PARTNERET SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM. TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA.
TIRANË, SHQIPËRI 2025

Projekti **TWIST: Drejt një Modeli të Ri të Sipërmarrjes Sociale në Asetet e Konfiskuara në Shqipëri**, u financua nga Bashkimi Evropian dhe u zbatua nga LIBERA-Shoqata, emra dhe numra kundër mafias, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Bashkia Tiranë, në bashkëpunim me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

LIBERA - Shoqata, emra dhe numra kundër mafias

LIBERA është një rrjet shoqatash, kooperativash sociale, lëvizjesh dhe grupesh, shkollash, sindikatash, dioqezash, famullish dhe grupe skautësh, të përfshirë në një angazhim jo vetëm kundër mafias, korrupsionit, krimit dhe atyre që i ushqejnë ato, por fuqimisht 'për': drejtësinë sociale, kërkimin e së vërtetës, mbrojtjen e të drejtave, politikën transparente, një ligjshmëri demokratike e bazuar në barazi, për një kujtesë të gjallë dhe të përbashkët, dhe për një qytetari që i përshtatet frymës dhe shpresave të Kushtetutës.

E themeluar në vitin 1995, ajo është e pranishme në të gjithë Italinë në 20 grupe koordinuese rajonale, 82 grupe koordinuese krahinore dhe 278 grupe lokale. 90 organizata ndërkombëtare i përkasin rrjetit Libera Internazionale, e shtrirë në 42 vende në Evropë, Afrikë dhe Amerikën Latine.

E angazhuar në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, Libera është e përfshirë në edukim, ndërgjegjësim dhe veprime mbi përgjegjësinë dhe ligjshmërinë demokratike.

Që në fillimet e saj, Libera ka promovuar projekte dhe nisma të shumta në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke përfshirë: promovimin e ligjit 109/96 për ripërdorimin social të pasurive të konfiskuara nga mafia dhe krimi i organizuar; kujtimin e viktimave të pafajshme të mafias dhe mbështetjen e familjeve të tyre.

Në veçanti, Libera ka realizuar regjistrimin e parë të përvojës pozitive të përdorimit social të pasurive të konfiskuara: janë mbi 867 shoqata dhe kooperativa që kanë në përdorim asete të konfiskuara në Itali, të cilat merren me përfshirjen dhe shërbimet për njerëzit, ri-integrimin në punë, trajnimin dhe grumbullimin e të rinjve, rigjenerimin urban dhe kulturor, shoqërimin e viktimave dhe familjeve të tyre.

Libera fokusohet gjithashtu në mbajtjen gjallë të kujtimit të viktimave të pafajshme të mafies. Këta burra, gra dhe fëmijë humbën jetën nga dhuna mafioze duke mbrojtur lirinë dhe demokracinë. Për këtë arsye, çdo vit më 21 mars, Libera organizon Ditën Kombëtare në kujtim të viktimave të pafajshme të mafies. Vetëm duke e kthyer kujtesën në një instrument angazhimi dhe përgjegjësie mund të mbillet fara e shpresës së re.

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PSh)

PSh u themelua në vitin 2001 me financim fillestar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Partnerët për Ndryshim Demokratik, tashmë të njohur si Partners Global. Si anëtare e Rrjetit të Partnerëve, i cili përfshin 19 organizata të pavarura në të gjithë Evropën, Amerikën, Afrikën dhe Lindjen e Mesme, PSh është e angazhuar në promovimin e ndryshimeve paqësore dhe demokratike.

Misioni i organizatës është forcimi i shoqërisë civile dhe bashkëpunimit ndërsektorial, duke përmirësuar kështu institucionet demokratike dhe zhvillimin ekonomik në Shqipëri. PA është e përkushtuar për fuqizimin e shoqërisë civile dhe nxitjen e bashkëpunimit midis organizatave jofitimprurëse, institucioneve shtetërore, akademisë dhe sektorit privat. Ky angazhim synon të adresojë sfidën kryesore të demokratizimit të Shqipërisë: forcimin e ndërveprimit midis qytetarëve dhe institucioneve shtetërore përmes një shoqërie civile të fuqizuar. Aktivitetet e PSh shtrihen në katër fusha kryesore: *1. Krijimi i një Mjedisit Mundësues dhe Zhvillim i Qendrueshëm për OJF-të; 2. Promovimi i Sipërmarrjes Sociale dhe Inovacionit; 3. Rritje e Aktivitetit Filantropik dhe Infrastrukturës Mbështetëse; dhe 4. Nxitja e një qeverisje me pjesëmarrje transparente dhe të përgjegjshme.*

Zhvillimi i një modeli inovativ standard për ripërdorimin social të aseteve të konfiskuara nga krimi i organizuar dhe korrupsioni përmes sipërmarrjeve sociale (SS-ve) ka një potencial të madh për në drejtim të mirëqenies dhe rigjallërimit të komuniteteve vulnerabël.

PA prezantoi në Shqipëri, në vitin 2016, modelin e ripërdorimit social të aseteve të konfiskuara përmes zbatimit të projektit "C.A.U.S.E – Asetet e Konfiskuara të Përdorura për Eksperimente Sociale". Kjo ishte nisma e parë e këtij lloji në vend dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, e cila ka konsistuar në një seri ndërhyrjesh me impakt afatgjatë në komunitetet e targetuara.

Bashkia Tiranë

Bashkia Tiranë drejton kryeqytetin e Shqipërisë, duke mbuluar planifikimin urban, shërbimet publike dhe zhvillimin e infrastrukturës. Ajo menaxhon sektorë të ndryshëm, përfshirë transportin, menaxhimin e mbetjeve dhe arsimin. Projektet kryesore përfshijnë iniciativa të mëdha për rindërtimin urban, përmirësimin e transportit publik dhe krijimin e hapësirave të gjelbra. Këto përpjekje janë pjesë e një strategjie më të gjerë për modernizimin e qytetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve. Përfshirja e Bashkisë së Tiranës si partnere ka kontribuar në rritjen e rolit të saj në informimin e bashkive të tjera mbi modelin e ripërdorimit social, duke siguruar bashkëpunimin e tyre gjatë zbatimit të projektit.

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK)

AAPSK është krijuar në vitin 2008 në bazë të ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004 "Për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar" i ndryshuar me ligjin nr.10 192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese ndaj pasurive". Është institucion shtetëror në varësi të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, dhe është përgjegjës për administrimin dhe/ose përdorimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga krimi i organizuar, si psh: llogaritë bankare, automjete, tokat, ndërtesa, makineri, pajisje apo ndërmarrje të konfiskuara. Selia qendrore e saj është në Tiranë.

OBJEKTIVAT DHE IMPAKTI I TWIST

Projekti TWIST – Drejt një Modeli të Ri të Sipërmarrjes Sociale në Asetet e Konfiskuara në Shqipëri synoi krijimin e një praktike të qëndrueshme të sipërmarrjes sociale në Shqipëri duke shfrytëzuar asetet e konfiskuara nga krimi i organizuar dhe korrupsioni në të mirë të komunitetit. Ai u përqendrua në forcimin e sipërmarrjes sociale për zhvillimin socio-ekonomik të komuniteteve të synuara, duke kontribuar në një ekonomi gjithëpërfshirëse.

TWIST angazhoi qytetarët shqiptarë, veçanërisht grupet e cënuara apo marginalizuara dhe ata të prekur apo të rrezikuar nga krimi i organizuar. Nëpërmjet modeleve të sipërmarrjeve sociale (SS-ve), ajo u mundësoi komuniteteve dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve) të përfitonin nga burimet e konfiskuara krimi të organizuar. Nisma kontribuoi në krijimin e mundësive të punësimit, duke ndikuar pozitivisht në grupet e cënueshme si viktimat e krimi të organizuar apo dhunës në familje, të miturit, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar dhe të papunët.

TWIST luajti një rol kyç në forcimin e bashkëpunimit dhe mbështetjes ndërsektoriale. Organizatat e shoqërisë civile, si dhe institucionet vendore dhe qendrore në Shqipëri, rritën sinergjinë dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre në mbështetje të aktivitetit sipërmarrës të SS-ve ekzistuese dhe krijimin e sipërmarrjeve sociale të reja në pasuritë e konfiskuara.

Kjo përpjekje lehtësoi zbatimin e modeleve të reja të sipërmarrjes me ndikim pozitiv dhe të rëndësishëm për komunitetet lokale në të gjithë vendin.

SHTYLLAT KRYESORE TË NDËRHJRJES SË PROJEKTIT

1 **Forcimi i kapaciteteve për 180 përfaqësues** të OJF-ve, institucioneve publike shqiptare dhe Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK-së) mbi menaxhimin e aseteve të konfiskuara përmes sipërmarrjeve sociale si një model i mirë i ripërdorimit social.

4 Mbi **15 aktivitete ndërgjegjëse** dhe **tryeza diskutimi** mbi ndikimin e sipërmarrjes sociale dhe modelin e ripërdorimit social të aseteve të konfiskuara.

2 **Menaxhimi i një skeme nën-grantimi** për ngritjen e 2 sipërmarrjeve sociale të reja në asetet e konfiskuara dhe zhvillimi i 8 modeleve të reja të sipërmarrjes nga OJF-të e mbështetura.

5 **Një vizitë studimore** në sipërmarrje sociale që operojnë në asete të konfiskuara në Itali për të mësuar nga praktikatat më të mira.

3 **Hartimi i 2 studimeve** për një menaxhim sa më të mirë të aktivitetit sipërmarrës dhe forcimit të rolit dhe angazhimit të institucioneve vendore në avancimin e ripërdorimit social.

6 **Një konferencë ndërkombëtare** mbi praktikatat më të mira dhe sfidat e zbatimit të ripërdorimit social të pasurive të konfiskuara.

FORCIM KAPACITETESH PER OJF-TË



TIRANË



SHKODËR



VLORË



SKEMA E NËN-GRANTIMIT

1

THIRRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME


3

SESIONE INFORMIMI TË ZHVILLUARA

**2 PRONA TË
KONFISKUARA**

ELBASAN

DURRËS



62 PJESËMARRËS

230,000 EURO

FONDI TOTAL



12,000 - 65,000 EURO

FONDI PËR PROJEKT

20

APLIKIME

10 PROJEKTE FITUESE

10 organizata zbatuese

12-14 MUAJ

Kohëzgjatja e mbështetjes
financiare nga projekti TWIST

5 VITE

Kontrata me AAPSK për
ripërdorimin pa pagesë të
pronave të konfiskuara

**LOT 1: NËN-GRANTE PËR KRIJIMIN E
SIPËRMARRJEVE SOCIALE NË
PRONA TË KONFISKUARA.**

4 APLIKIME

**LOT 2: NËN-GRANTE PËR MBËSHTETJEN E
MODELEVE EKZISTUESE APO KRIJIMIN E
SIPËRMARRJEVE SOCIALE TË REJA.**

16 APLIKIME

PREZANTIMI I PROJEKTIT TWIST



Prill 2022


PREZANTIMI ZYRTAR I ZBATUESVE TË INICIATIVAVE



Tetor 2023

INAUGURIMI I QENDRËS “ART DHE AKTIVIZËM”, DURRËS

Shkurt 2024









Mars 2025



INFORMACION MBI
SIPËRMARRJET
SOCIALE TË
MBËSHTETURA

QENDRA “ART DHE AKTIVIZËM”

ORGANIZATA ZBATUESE

“Durrësi Aktiv” është një organizatë e re e krijuar në vitin 2019 në Durrës. Misioni i saj është të frymëzojë dhe fuqizojë qytetarët drejt aktivizmit për të ndryshuar realitetin e tyre. Qëllimi i organizatës është të përmirësojë jetën e qytetarëve përmes ndryshimeve sociale, ekonomike, politike dhe mjedisore.

📍 “Shëtitorja “Taulantia”, Rruga “Epikadeve”,
Ndërtesa 1047, Ap. 3D, Durrës, Shqipëri



durresiaktiv@gmail.com



www.durresiaktiv.al



Tel: +355 692936395

SIPËRMARRJE SOCIALE TË MBËSHTETURA


Kohëzgjatja e projektit: Shtator 2023 - Gusht 2024
Buxheti total: 65,000 Euro
Shtrirja gjeografike: Bashkia Durrës

QËLLIMI I NISMËS

Qendra “Art dhe Aktivizëm” në Durrës është një sipërmarrje sociale e sapo krijuar dhe operon në një pronë të konfiskuar prej zyrtarë të lartë të korruptuar dhe krimi i organizuar. Nëpërmjet këtij aktiviteti sipërmarrës, “Durrësi Aktiv” frymëzon artistët që nëpërmjet fuqisë së artit të krijojnë ndryshime pozitive si dhe të eksplorojnë mënyra krijuese për të gjeneruar vlera sociale dhe ekonomike.

REZULTATET

- Shndërrimi i pronës së konfiskuar në një hapësirë interaktive me studio, galeri dhe punishte për artistë të rinj.
- Hartimi i një plani biznesi dhe marketingu për të siguruar financimin e mëtejshëm dhe qëndrueshmërinë e sipërmarrjes sociale.
- Promovimi i punimeve artistike të të rinjve dhe aktivitetit sipërmarrës të Qendrës në evente publike dhe panaire kombëtare.
- Krijimi i faqes online <https://durresiaktiv.al/shop>, për të ekspozuar të gjitha veprat e artistëve të rinj.
- Gjenerimi i të ardhurave për 22 artistë të rinj, nëpërmjet ekspozimit të tyre në seminare, ekspozita, panaire dhe rrjetëzimit profesional mes komunitetit të artistëve.



TË RUAJMË TRADITËN

ORGANIZATA ZBATUESE

Fondacioni Joscelyn u krijua në vitin 2015 në Elbasan. Misioni i tij është të kontribuojë në fuqizimin e komunitetit, veçanërisht të fëmijëve dhe të rinjve, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve psikosociale, edukimit formal dhe joformal, ndërgjegjësimit dhe advokimit.

📍 Lagjia "28 Nëntori", Rruga "Mefail Bicaku",
Elbasan, Shqipëri

✉ joscelyn.foundation@gmail.com

🌐 www.joscelynfoundation.org

☎ Tel: +355 694307493

SIPËRMARRJE SOCIALE TË MBËSHTETURA

Kohëzgjatja e projektit: Gusht 2023 - Shtator 2024
Buxheti total: 58,220 Euro
Shtrirja gjeografike: Bashkia Elbasan

QËLLIMI I NISMËS

Kjo nisëm kontribuoi në rritjen e aktivitetit të sipërmarrjes sociale "Tradita Ime Artizanale" që është krijuar dhe zhvillon veprimtarinë e saj në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar në Elbasan. Ajo fuqizoi gratë në nevojë, të papuna për një periudhë të gjatë kohe, duke u rritur aftësitë dhe punësimin afatgjatë.

REZULTATET

- Punësimi i 3 grave të papuna për një periudhë të gjatë pranë sipërmarrjes sociale.
- Rritje e kapaciteteve të 10 grave dhe vajzave nga grupet në nevojë në profesionin e tezgjahut.
- Informim dhe ndërgjegjësim për 100 të rinj (60 vajza dhe 40 djem) mbi sipërmarrjen sociale dhe ndikimin e saj në komunitet.
- Rritje e shitjeve dhe të ardhurave nëpërmjet marketingut të produkteve në panairët lokale, kombëtare dhe rajonale.
- Forcim i bashkëpunimit dhe partneritetit me institucionet lokale dhe qendrore (Bashkia Elbasan, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, etj.), duke promovuar sipërmarrjen sociale, produktet e saj dhe ndikimin socio-ekonomik në komunitetin e synuar.



PROSPERITET

ORGANIZATA ZBATUESE

Qendra Sociale në Ndhimë të Njerëzve në Nevojë - QSNNN është themeluar në Fushë-Arrëz. Misioni i saj është të forcojë komunitetin në zonën veriore të Shqipërisë nëpërmjet programeve të informimit, edukimit, sipërmarrjes dhe ndërgjegjësimit, shërbimeve komunitare, advokimit dhe mbrojtjes së mjedisit.



Rruga "Demokracia", Kati 2-të, Fushë-Arrëz,
Shqipëri



shoqata_qsnnn@hotmail.com



www.qsnnn.org



Tel: +355 695863300

SIPËRMARRJE SOCIALE TË MBËSHTETURA

Kohëzgjatja e projektit: Shtator 2023 - Gusht 2024

Buxheti total: 12,000 Euro

Shtrirja gjeografike: Bashkia Fushë-Arrëz

QËLLIMI I NISMËS

Kjo ndërhyrje fuqizoi më tej gratë e pafavorizuara në zonën e Fushë-Arrëzit, në veri të Shqipërisë, duke maksimizuar mirëqenien e tyre sociale dhe ekonomike, si dhe ka përmirësuar mirëfunksionimin e sipërmarrjes sociale "PROSPERITET".

REZULTATET

- Rritje e aktivitetit të sipërmarrjes sociale "PROSPERITET", e cila solli mbështetje për më shumë gra si dhe zgjeroi ndikimin në komunitet.
- Përfitimi i statusit zyrtar "Sipërmarrje Sociale" nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, solli ndërgjegjësim për potencialin e saj për fuqizim ekonomik dhe zhvillim të qendrueshëm të zonës.
- Rritje e kapaciteteve të 18 grave të pafavorizuara, në identifikimin, grumbullimin, përpunimin, ruajtjen dhe paketimin e bimëve mjekësore dhe frutave të pyllit.
- Punësimi i 9 grave të pafavorizuara nga bashkia Fushë-Arrëz pranë sipërmarrjes sociale.
- Përmirësimi i industrisë së bimëve mjekësore duke lehtësuar aksesin në 53 bimë mjekësore dhe aromatike lokale, e cila ndikoi edhe në përmirësim të ekonomisë së zonës.



NXITJA E VETËPUNËSIMIT TË TË RINJVE ROMË NËPËRMJET ARTIZANATIT TË THURJES SË SHELGUT

ORGANIZATA ZBATUESE

"Shoqata Multifunksionale për Kulturë, Arsim dhe Zhvillim" në qarkun e Gjirokastrës kontribuon në mbrojtjen e të drejtave, angazhimin, integrimin dhe promovimin e të rinjve nëpërmjet ndërgjegjësimit, advokimit, ngritjes së kapaciteteve dhe nxitjes së qytetarisë aktive në komunitetet e tyre.



"Lagjia "18 Shtatori", Rruga "Tahir Kadare",
Ndërtesa. 23/18, Gjirokastrë, Shqipëri



shoqata.mkezh@hotmail.com



Tel: +355 694640798

SIPËRMARRJE SOCIALE TË MBËSHTETURA

Kohëzgjatja e projektit: Shtator 2023 - Qershor 2024

Buxheti total: 11,993 Euro

Shtrirja gjeografike: Bashkia Gjirokastrë

QËLLIMI I NISMËS

Projekti kontribuoi në fuqizimin e të rinjve romë duke rritur aftësitë e tyre dhe duke promovuar kulturën tradicionale të thurjes së shelgut. Ai nxiti vetëpunësimin midis artizanëve të rinj, duke u mundësuar atyre të prodhojnë produkte artizanale me qëllim edhe mbështetjen e trashëgimisë kulturore.

REZULTATET

- Rritje e kapaciteteve të 2 artizanëve dhe 6 të rinjve nga komuniteti Rom në artizanatin e thurjes së shelgut, duke rritur mundësitë e tyre për punësim dhe përfshirje sociale.
- Disenjimi dhe prodhimi i 30 modeleve të reja të punimeve me dorë duke përdorur teknikat e thurjes së shelgut.
- Hartimi i një modeli biznesi dhe strategjie marketingu online për produktet e thurjes së shelgut, duke synuar sektorin e turizmit në Gjirokastrë dhe shitjet online nëpërmjet platformave të mediave sociale.
- Promovimi i produkteve të artizanatit të shelgut përmes rrjeteve sociale dhe panaireve, duke demonstruar një model të ri vetëpunësimi për të rinjtë romë si një mjet i qëndrueshëm për fuqizimin socio-ekonomik të tyre.



UNIONI I KOOPERATIVËS BUJQËSORE ROME

ORGANIZATA ZBATUESE

Sëbashku për Integrimin Rom (TIRC) punon për të nxitur zhvillimin ekonomik të komunitetit Rom dhe integrimin e tyre të barabartë në shoqërinë shqiptare. Kjo arrihet përmes angazhimit të të rinjve dhe përforcimit të zërit të romëve në fusha të tilla si bujqësia, arsimi, punësimi, shëndetësia dhe strehimi.



Njësia Administrative Dërmenas,
Baltëz, Fier, Shqipëri



gendratirc@gmail.com



Tel: +355 698154740

SIPËRMARRJE SOCIALE TË MBËSHTETURA

Kohëzgjatja e projektit: Shtator 2023 - Qershor 2024
Buxheti total: 11,995 Euro
Shtrirja gjeografike: Bashkia Fier

QËLLIMI I NISMËS

Nisma kontribuoi në krijimin e një kooperative bujqësore të qëndrueshme nga fermerë të komunitetit Rom, duke asistuar në përfitim të pronësisë së tokës dhe rritjen e aftësive të fermerëve. Ky projekt aftësoi fermerët me njohuri për tregun dhe ofroi mbështetje thelbësore për praktikën e qëndrueshme bujqësore dhe rritjen ekonomike të këtij komuniteti.

REZULTATET

- Krijimi i Kooperativës Bujqësore duke angazhuar pesë fermerë lokalë romë.
- Mbështetje financiare për fermerët e komunitetit rom për kultivimin dhe mbjelljen e tokës.
- Rritje e aftësive dhe kapaciteteve të 10 fermerëve mbi rregullat dhe procedurat për certifikimin e pronave, formimin e kooperativave, dinamikën e tregut bujqësor dhe strategjitë e marketingut.
- Rritje e marketimit dhe promovimit të sipërmarrjes sociale nëpërmjet ekspozimit efektiv në tregjet formale dhe online.



SHËRBIME PASTRIMI “DRITA”

ORGANIZATA ZBATUESE

Shoqata “Zëri Rom në Shqipëri” synon të promovojë zhvillimin social dhe ekonomik të komunitetit Rom dhe integrimin e tyre të barabartë në shoqërinë shqiptare. Kjo arrihet nëpërmjet fuqizimit të të rinjve, fuqizimit të zërit të romëve në fushën e arsimit, punësimit, shëndetësisë dhe strehimit, si dhe advokimit për respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të komunitetit Rom.

📍 Lagjia Bishanakë, Fier, Shqipëri

✉ voiceofroma_inalbania@yahoo.com

🌐 www.voiceofromainalbania.com

☎ Tel: +355 696344192

Kohëzgjatja e projektit: Shtator 2023 - Gusht 2024

Buxheti total: 11,937.50 Euro

Shtrirja gjeografike: Bashkia Fier

QËLLIMI I NISMËS

Sipërmarrja sociale “Shërbime Pastrimi Drita” fuqizoi përfshirjen dhe integrimin socio-ekonomik të anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian që jetojnë në kushte të pafavorshme. Kjo u arrit përmes krijimit të vendeve të sigurta dhe të qëndrueshme të punës, përmes rritjes së aktivitetit të sipërmarrjes sociale.

REZULTATET

- Hartimi i një plani biznesi dhe marketingu që kontribuoi në rritjen e aktivitetit sipërmarrës.
- Punësimi i 10 grave dhe të rinjve romë dhe egjiptianë nga komuniteti rom dhe egjiptian, duke siguruar gjenerim të ardhurash, pra jetesë më të mirë.
- Krijimi i bashkëpunimit dhe partneritetit me institucionet lokale vendore (Bashkia Fier, Zyra Lokale e Punësimit) në identifikimin e individëve të papunë nga komuniteti rom për të mundësuar punësimin e tyre në të ardhmen në sipërmarrjen sociale “Shërbime pastrimi Drita”.
- Krijimi i partneritetit me bizneset lokale, e cila kontribuoi në gjenerim të ardhurash dhe qëndrueshmërinë e sipërmarrjes sociale.



ART'I ZANAVE FITON DHE DHURON

ORGANIZATA ZBATUESE

Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë" synon të promovojë dhe garantojë të drejtat e njeriut, duke siguruar që çdo person të trajtohet në mënyrë të barabartë nga dhe përpara ligjit. Qendra advokon për mbrojtjen nga çdo formë diskriminimi në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, përkatësisë etnike, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, statusit ekonomik, arsimor ose social, shtatzënisë, përkatësisë dhe përgjegjësisë prindërore, moshës, statusit familjar, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicionit gjenetik, paaftësisë, anëtarësimit në një grup të caktuar apo ndonjë arsye tjetër, me fokus të veçantë në grupet e cënueshme.

📍 Rruga e Murgeshave, Nr. 6, Gjuhadol,
Shkodër, Shqipëri

✉ qendragruashk@yahoo.com

🌐 www.hapatelehte.org

☎ Tel: +355 674060021

SIPËRMARRJE SOCIALE TË MBËSHTETURA

Kohëzgjatja e projektit: Shtator 2023 - Gusht 2024
Buxheti total: 11,970 Euro
Shtrirja gjeografike: Bashkia Shkodër

QËLLIMI I NISMËS

Përmirësimi i shërbimeve të ofruara nga sipërmarrja sociale "Art'i Zanave" ka kontribuar në qendrueshmërinë e kësaj sipërmarrjeje, dhe për rrjedhojë edhe rritjen e numrit të grave dhe vajzave viktime të dhunës në familje që përfitojnë shërbime psikosociale dhe ligjore falas.

REZULTATET

- Zgjerimi i gamës së shërbimeve që solli rritjen e klientelës si dhe rritje të shërbimit të cateringut.
- Punësimi i 2 grave nga grupet në nevojë me kohë të plotë, duke siguruar pavarësinë e tyre financiare.
- Mbështetje për 82 fermerë dhe prodhues vendas nga promovimi dhe shitja e produkteve lokale, me kontribut në ekonominë lokale.
- Rritje të të ardhurave nga shitja e produkteve të freskëta dhe të përpunuara, duke kontribuar në fuqizimin financiar të sipërmarrjes sociale.
- Mbështetje ligjore falas për 250 individë nëpërmjet shërbimit kundër dhunës, duke ofruar këshillim të rëndësishëm juridik për viktimat e dhunës në familje.
- Edukim i 150 fëmijëve dhe nënave të tyre për rëndësinë e të ushqyerit shëndetshëm.



TIRANA GREEN LIVING 2

ORGANIZATA ZBATUESE

Qendra për Edukim Kulinar (QEK) është një organizatë jofitimprurëse që shërben si Qendër Revolucionare për Edukimin Kulinar. Përtej qëllimit të saj parësor për edukimin në kulinari, QEK përdor burime alternative për t'u angazhuar gjithnjë e më shumë në sisteme të qendrueshme të ushqimit të shëndetshëm dhe për të promovuar një jetesë të qendrueshme.

📍 Rruga "Muhamed Gjollësja", Nr. 7,
3/81, Tiranë, Shqipëri

✉ info.gek@gmail.com

🌐 www.gek.al

☎ Tel: +355 683333215

SIPËRMARRJE SOCIALE TË MBËSHTETURA

Kohëzgjatja e projektit: Shtator 2023 - Gusht 2024
Buxheti total: 12,000 Euro
Shtrirja gjeografike: Bashkitë: Tiranë, Kamëz dhe Vorë

QËLLIMI I NISMËS

"Tirana Green Living 2" rriti aktivitetin e saj sipërmarrës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, përmirësimit të aftësive dhe punësimit për grupet e marginalizuara. Gjithashtu u rrit ndërgjegjësimi për përdorimin e prodhimeve lokale, duke shfrytëzuar praktikatat më të mira të QEK-ut për të nxjerrur një fuqi punëtore të kualifikuar dhe për të promovuar një komunitet më gjithëpërfshirës dhe të ndërgjegjshëm ndaj mjedisit.

REZULTATET

- Rritje e aftësive prodhuese dhe shërbimeve të sipërmarrjes sociale nëpërmjet blerjes së pajisjeve të reja.
- Rritje e të ardhurave me 30%, si dhe shtim i klientëve të rinj që blejnë produktet.
- Rritje e kapaciteteve për 20 të rinj dhe gra me nevojë të veçanta, përfshirë ato me probleme të shëndetit mendor, në gatim dhe aftësi për jetën, duke rritur kështu mundësitë e tyre të punësimit, vetëbesimit dhe autonomisë.
- Punësimi i 5 grave (4 me kohë të plotë dhe 1 me kohë të pjesshme) në sipërmarrjen sociale.
- Sigurimi i vakteve ditore të përgatitura për 2,000 individë dhe 600 familje të pafavorizuara përgjatë 10 muajve, duke adresuar çështjen e pasigurisë ushqimore dhe mbetjeve ushqimore.
- Mbështetje për fermerët dhe prodhuesit vendas duke blerë produktet e tyre.



KREMI ORGANIK ROSKOVEC

ORGANIZATA ZBATUESE

Organizata "Gruaja, Komuniteti, Mjedisi-Harmonizuar per Zhvillim" parashikon një shoqëri ku barazia përbën themelin e harmonisë dinamike midis komunitetit dhe mjedisit. Në këtë vizion, gratë janë pjesë përbërëse e së tërës, duke kontribuar dhe duke përfitur nga një komunitet produktiv.

📍 Roskovec 9306, Fier, Shqipëri

✉ hoxharonada@yahoo.com

☎ Tel: +355 688450014

SIPËRMARRJE SOCIALE TË MBËSHTETURA

Kohëzgjatja e projektit: Shtator 2023 - Gusht 2024

Buxheti total: 12,000 Euro


Shtirirja gjeografike: Bashkia Roskovec

QËLLIMI I NISMËS

Kjo ndërhyrje synoi fuqizimin social dhe ekonomik të grave të papuna dhe viktimave të dhunës në familje në Bashkinë Roskovec. Duke zgjeruar gamën e produkteve dhe strategjinë e marketingut të sipërmarrjes ekzistuese sociale, nisma synoi të përmirësojë integrimin e këtyre grave në komunitet dhe të forcojë aktivitetin e kësaj sipërmarrje.

REZULTATET

- Rritje e kapaciteteve të 15 grave në procesin e prodhimit të kremit organik.
- Rritje e shitjeve të kremit artizanale si dhe promovimi dhe marketingu i këtij produkti të ri në qytetet Roskovec, Fier dhe Tiranë.
- Sigurimi i të ardhurave nga shitjet, dhe rrjedhimisht rritje ekonomike për 15 gra nga grupet e marginalizuara në Bashkinë Roskovec.
- Rritje e partneritetit me Bashkinë Roskovec dhe bizneset lokale për të identifikuar gra të tjera të papuna dhe për të lehtësuar përfshirjen e tyre në tregun e punës.



TURIZËM PËR NDRYSHIM

ORGANIZATA ZBATUESE

CELIM operon në Shqipëri që nga viti 1999 dhe misioni i tij është: ndjekja e një aksioni konkret dhe efikas të bazuar mbi një zhvillim të shoqërisë në formë të bashkuar, solidare dhe të qëndrueshme. Fokusi i organizatës është zbatimi i projekteve veçanërisht në mbrojtjen e mjedisit dhe ndikimin për ndryshim.

📍 Rruga "Ismail Qemali", Nr. 154/4, Ap. 13,
Vlorë, Shqipëri

✉ albania@celim.it

🌐 www.celim.it

☎ Tel: +355 694307048

QËLLIMI I NISMËS

Ndërhyrja "Turizëm për Ndryshim" e implementuar nga CELIM Shqipëri, kontribuoi në krijimin e vendeve të punës për të rinjtë e papunë. CELIM ngriti Zyrën e Parë Informuese në Bashkinë Memaliaj përgjatë shtratit të lumit Vjosa, me qëllim promovimin dhe rritjen e turizmit vendas.

REZULTATET

- Rritje e kapaciteteve të 10 të rinjve (4 vajza dhe 6 djem) mbi legjislacionin për turizmin, organizimin dhe menaxhimin e udhëtimeve, marketingun si dhe aftësimin në përdorimin e gjuhës angleze në fushën e turizmit.
- Hartimi i një plani biznesi dhe strategjie marketingu për të siguruar qëndrueshmërinë e aktivitetit sipërmarrës.
- Ngritje e Zyrës së Parë të Informacionit pranë fshatit Toc, në Bashkinë Memaliaj.
- Punësimi me kohë të pjesshme i 4 grave dhe vajzave të kategorisë NEET, të cilat ofrojnë shërbime informacioni lidhur me turizmin në Zyrën e Informacionit.
- Krijimi i dy paketa turistike për zonën përgjatë lumit Vjosa.
- Forcimi i partneritetit me Bashkinë Memaliaj për të siguruar zbatimin efektiv të ndërhyrjes dhe qëndrueshmërinë e tij.
- Rritje e bashkëpunimit me bizneset lokale, hotelet, entitetet e agroturizmit dhe prodhuesit e ushqimit dhe verës për të përmirësuar ofertën turistike lokale.

SIPËRMARRJE SOCIALE TË MBËSHTETURA

Kohëzgjatja e projektit: Shtator 2023 - Gusht 2024
Buxheti total: 11,700 Euro
Shtrirja gjeografike: Bashkia Memaliaj



VIZITË STUDIMORE

Dhjetë (10) përfaqësues nga sipërmarrjes sociale të mbështetura, së bashku me përfaqësues nga Partnerët Shqipëri dhe Bashkia Tiranë, morrën pjesë në një vizitë studimore në Itali, e cila u zhvillua në muajin nëntor 2023.

Kjo përvojë rezultoi tepër pozitive për suksesin e projektit, me zgjerimin e njohurive për ripërdorimin social të aseteve të konfiskuara bazuar në shembujt italianë. Vizita mundësoi shkëmbime eksperiencash profesionale ndërmjet kolegësh, sipërmarrjeve sociale shqiptare dhe italiane, si dhe njohje më të mirë të kuadrit ligjor italian i cili mund të ndihmojë në përmirësimin e legjislacionit shqiptar në drejtim të ripërdorimit social të aseteve të konfiskuara.

Ndarja e këtyre përvojave pozitive nxiti besimin në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe transparente.



Nëntor 20 23



STUDIME & PUBLIKIME

"Raport i Vlerësimit të Impaktit - Projekti TWIST" është një është një studim kërkimor vlerësues mbi ndikimin e projektit TWIST, veçanërisht në lidhje me efektet e tij tek organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) përfituese dhe marrëdhëniet me institucionet vendore e qendrore të targetuara në Shqipëri. Studimi shqyrton, përmes një analize kritike, përmes intervistave, fokus – grupeve të organizuara dhe analizës së dokumenteve, arritjet dhe sfidat nga ndërhyrjet.


Gjithashtu, shqyrton ndikimin e sipërmarrjeve sociale, për të punuar me komunitete në nevojë dhe grupe të cënueshme, si dhe kapacitetin e tyre për të zhvilluar partneritete strategjike me institucione publike. Nga kjo perspektivë, studimi ofron rekomandime për të forcuar rolin e bashkive në këtë proces dhe jep udhëzime mbi trajektore të mundshme zhvillimi për të nxitur marrëdhëniet midis aktorëve të targetuar në projekt.



STUDIME & PUBLIKIME



Studimi - "Ripërdorimi social i pronave të konfiskuara nga krimi i organizuar dhe korrupsioni nga OJF-të me një rol dhe autoritet të shtuar të institucioneve të vetëqeverisjes vendore", paraqet një analizë të kuadrit ligjor për ripërdorimin social të pronave të konfiskuara nga OJF-të dhe rolin e njësive të vetëqeverisjes vendore në këtë drejtim, dhe jep rekomandime për rritjen e rolit të tyre në këtë proces.

Veçanërisht, studimi ofron një analizë mbi kontributin e SS-ve në integrimin social dhe punësimin e komuniteteve të marginalizuara. Është bërë një vlerësim i impaktit në këndvështrimin gjinor, të aktiviteteve të sipërmarrjes sociale në komunitetet e pafavorizuara, duke paraqitur të dhëna dhe rekomandime thelbësore për të ardhmen.





TRYEZË KOMBËTARE PËR PREZANTIMIN E STUDIMIT
TIRANË, MAJ 2024



TRYEZË LOKALE PËR PREZANTIMIN E STUDIMIT
FIER, MAJ 2024



TRYEZË LOKALE PËR PREZANTIMIN E STUDIMIT SHKODËR, NËNTOR 2024



TRYEZË LOKALE PËR PREZANTIMIN E STUDIMIT
KORCË, NËNTOR 2024



**TRYEZË LOKALE PËR PREZANTIMIN E STUDIMIT
GJIROKASTËR, NËNTOR 2024**



KONFERENCË NDËRKOMBËTARE NGA FITIMET E PALIGJSHME TEK E MIRA PUBLIKE: E ARDHMJA E ASETETEVE TË KONFISKUARA



KONFERENCË NDËRKOMBËTARE
NGA FITIMET E PALIGJSHME TEK E MIRA PUBLIKE: E ARDHMJA E ASETETEVE TË
KONFISKUARA

Copy of En TWIST...
https://gazetashqiptare.al/2024/02/22/apartamenti-sekuestruar-adriatik-lalles-kthehet-ne-qender-sociale-ministri-balla-rezultat-i-prekshem-i-reformes-ne-drejttesi...

FILLIMI KRYESORE AKTUALITET POLITIKE EKONOMI KULTURE SPORT BOTA, SHOW-BIZZ

Kryesore

Apartamenti i sekuestruar i Adriatik Lallës kthehet në qendër sociale, ministri Balla: Rezultat i prekshëm i reformës në drejtësi...



https://tvkinali.al/konfiskua-ish-zyrtarit-te-larte-apartamenti-ne-durres-do-te-sherbeje-si-qender-multifunksionale

Kryesore | Lajme | Te Fundit

Iu konfiskua ish-zyrtarit të lartë, apartamenti në Durrës do të shërbejë si qendër multifunksionale

5 min lexim - Publikuar 18:31, 22 Shkurt 2024

f x



YouTube

Financuar nga Bashkimi Evropian

SOCIAL CRAFTING GARAGE SARANDA

Kjo ndërmarje sociale u krijua nga Instituti Migraçionit Zhvillimit dhe Integrimit, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian përmes projektit "CAUSE - Përdorimi i Pronave të Konfiskuara për Sipërfaqe Sociale".


Ky projekt shpërndahet nga

PARTNERËT SHQIPËRI PËR NËNRYSHIM DHE ZHVILLIM



aktualitet Politike Rajon Bota Sport Ekonomi Emisione Edicionet Moli English Life Plus Opinion


Apartamenti i Lallës, qendër sociale", Balla: Të pasuritë e konfiskuara, në shërbim të shtetit



2.250 € MASTER 2024-2025

KËNDI I NJOFTIMEVE


Opinion



RTSH 227K subscribers

Apartamenti sekuestruar nga krimi, Hoxha: Jane "karburanti" i paligjshmërisë

TE FUNDIT



HOME EDICIONET LOKALE KRONIKE POLITIKE SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË

TE FUNDIT SOCIALE DRITË PUNËS SPECIALE LAJME TË MIRA LIFESTYLE VIP & SPORTAKËL RECETA HOROSKOPI DOSE FOTOGALERI VIDEOGA

POP 5



MC

KOSU

Pasuritë e konfiskuara me burim të paligjshëm, Hoxha: Kthim në shërbim të publikut

12 SHKURT 2024, 11:46



Pasuritë e konfiskuara me burim të paligjshëm, ministri Hoxha: Po godasim krimin në pikën më nevralgjike, qëllim kthimi në shërbim të publikut!



www.libera.it
international@libera.it



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



www.partnersalbania.org
partners@partnersalbania.org



www.tirana.al
info@tirana.al